



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

Në bazë të nenit 12 pika "c" të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40 , nenit 31.2,"a" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe në bazë të nenit 43 pika 3 të Rregullave Financiare dhe Shpenzimet e Thesarit 02- Shpenzimi i Parave Publike, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur me _____ 2011 viti, miraton këtë:

DRAFTË

RR E G U L L O R E PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TE NDARJES SË MJETEVE FINANCIARE NGA FONDI PËR TRANSFERE DHE SUBVENCIONE PËR NDIHMË MOMENTALE ENTITETEVE PUBLIKE DHE JO PUBLIKE

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Qëllimi

Neni 1

1.1. Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret dhe procedurat e ndarjes së mjeteve të buxhetit të Komunës – fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jo publike.

1.2. Bazuar në fondin e ndarë buxhetorë të subvencioneve dhe transferove për vitin aktual, Kryetari i Komunës, sipas kërkesave të arsyetuara-të palëve, ndanë mjete financiare buxhetore – ndihmë momentale, për entitete publike dhe jo publike, në shumën e përcaktuar me këtë rregullore.

Neni 2.

Ndihmë momentale sipas kësaj rregullore konsiderohet ndihma e menjëhershme në të gatshme që propozohet nga komisioni përkatës i formuar me vendim të Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Neni 3

Ndihma momentale për entitetet publike (institucionet jo profitabile)

Ndihma momentale për entitetet publike (institucionet joprofitabile) përfshin mbështetjen që u jepet institucioneve kulturore, sportive dhe jo qeveritare, ku nuk kërkohet asgjë specifike si kthim për këto pagesa.

Neni 4

Kërkesat e entiteteve publike për subvencione duhet t'i drejtohen Kryetarit të Komunës përmes zyrës së pranimit. Kërkesa duhet të jetë e kompletuar me dokumentacion mbështetës si: certifikata e regjistrimit, arsyetimi i kërkesës me prova të qarta dhe bindëse, dhe nr. i llogarisë bankare të entitetit publik.

Neni 5

Kryetari i Komunës pas pranimit të kërkesës autorizon Drejtorin të jep mendim profesional për përfituesit. Propozimi i dërgohet për aprovim Kryetarit të Komunës. Kryetari aprovon kërkesat e justifikuara dhe të dëshmuara me dokumentacionin përcjellës.

Neni 6

Kryetari i Komunës merr vendim lidhur me kërkesën e entitetit publik deri në shumën e përcaktuar me këtë rregullore. Nëse ndihma ka të bëjë me shumë më të madhe, ajo procedohet në KPF përkatësisht kuvendin e komunës për miratim.

Subvencionet për entitetet jopublike (familjet dhe individët)

Neni 7

Në rastet urgjente të fatkeqësive të ndryshme natyrore, varfërisë të skajshme për familje apo individ të caktuar për banoret e Komunës së Vushtrrisë, sëmundjes së rëndë të cilat kërkojnë mjekim të kushtueshëm, Kryetarit i Komunës sipas kërkesave të arsyetuara ndan ndihma momentale nga fondi për transfere dhe subvencione të komunës.

Neni 8

Kryetarit i Komunës lejon ndarjen e subvencioneve për entitete publike dhe jo publike në shumë deri në 500.00 €. Për çdo shumë të më të lartë nga ajo e përcaktuar në paragrafin paraprak vendosë Kuvendi i Komunës.

Neni 9

Ndihmat momentale nga fondi për transfere dhe subvencione përjashtojnë transferet për qëllime kapitale , d.m.th. për qëllim të mundësimit që pranuesit të përvetësojnë pasuri kapitale.

Neni 10

Subvencionet (mjetet nga fondi për transfero dhe subvencione) janë pagesat e njëanshme, jo të kthyeshme, për institucionet joprofitabile familjet dhe individët.

Neni 11

Kriteret që duhet të plotësohen për të qenë përfitues i kësaj ndihme:

- Sëmundja e rëndë e konstatuar me dokumentacionin mjekësorë të specialistit,
- Gjendja e rëndë ekonomike-familjare e vërtetuar,
- Dëshmia e shpenzimeve mjekësore dhe shpenzimeve tjera.
- Dëshmia për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë elementare

Neni 12

Kërkesë për ndihmë momentale mundë të paraqesin vetëm personat që janë banorë rezidentë të komunës së Vushtrrisë.

III. Organi kompetent për shqyrtimin e kërkesave

Neni 13

13.1 Kompetent për shqyrtimin e kërkesave të etniteteve jo publike për ndihmën momentale është komisioni i formuar nga drejtori I DSHMS-së . Ky komision ka për detyrë që të shqyrtoj kërkesat me dokumentacion të kompletuar dhe propozon ndihmën momentale .

13.2 Kërkesat e pa kompletuara, komisioni nuk do t'i procedoj më tutje.

13.3 Kërkesat që nuk i plotësojnë kriteret për ndihmën momentale do të refuzohen nga Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale me propozim të komisionit.

Neni 14

Shuma e ndihmës momentale për etnitetet jo publike propozohet nga komisioni (shuma minimale është 50€ - kurse shuma maksimale është 300 €)

dhe personi I caktuar mund të ndihmohet vetëm një herë në vit, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.

Neni 15

Komisioni listën e specifikuar të propozuar për ndihma momentale ia dorëzon drejtorit të DSHMS-së I cili ka mundësi ta ndryshoj para se ti propozohet për miratim Kryetarit të Komunës duke potencuar arsyetimin për ndryshime.

Neni 16

Kërkesa duhet të shqyrtohet dhe ndihma të kryhet në afatin sa më të shkurtër të mundshëm e jo më larg se 30 ditë.

Neni 17

IV. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe DSHMS-e e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 18

Për të gjitha të metat-zbrazësit që paraqiten në këtë rregullore,do të mbisundojnë dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 19.

V. Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hynë ne fuqi pas miratimit në kuvend dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi

Arsyetim

Qëllimi i kësaj propozim-rregulloreje është që paraja publike të menaxhohet në mënyrë sa më të drejt, racionale dhe në mënyrë sa më transparente, ashtu siç parashihet në udhëzimin administrative 2005/08 dhe rregullores dhe udhëzimit mbi thesarin 02-shpenzimi i parasë publike –neni 43 pika 3.

Duke u nisur nga qëllimi i lartë shënuar e kemi pare të arsyeshme që këtë propozim-rregullore të ja propozojmë Kuvendit Komunal në Vushtrri për aprovim, sepse në këtë propozim-rregullore janë paraparë kritere të cilat ja u lehtësojnë punën e menaxhimit të parasë publike, e cila është paraparë për subvencione nga ana e Zyrës së kryetarit dhe DSHMS-së që domethënë se duke u zbatuar kriteret e lartë cekura do të arrihet edhe qëllimi i kësaj propozim-rregulloreje.

Vushtrri, Janar 2011

Drejtori i DSHMS-së

Dr. Safet Idrizi